



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 213

Tiranë – E hënë, 11 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 1.12.2017	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ish-Ministria e Integritimit Evropian te Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të godinës së ish-Ministrit të Integritimit Evropian..... 11169
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 1.12.2017	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrit të Brendshme, të pasurive me numër 8/1 dhe 8/3, zona kadastrale 8150, me emërtimin “Godina e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, ndodhur në bulevardin “Bajram Curri”, Tiranë..... 11171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 1.12.2017	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, për programin “Rezerva ndërkufitare e biosferës në Prespë”..... 11172
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 1.12.2017	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Kryeministrinë..... 11175
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 19, datë 20.11.2017	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 3, datë 10.2.2016, “Për formatin e aktit të konstatimit, procesverbalit të gjobës dhe aktit të konfiskimit të AMLF-së”..... 11176

VENDIM
Nr. 704, datë 1.12.2017

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA ISH - MINISTRIA E
INTEGRIMIT EVROPIAN TE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS
PUBLIKE DHE KOMISIONI I
PROKURIMIT PUBLIK, TË GODINËS SË
ISH - MINISTRISË SË INTEGRIMIT
EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ish - Ministria e Integrimit Evropian te Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të godinës së ish-Ministrisë së Integrimit

Evropian, sipas formularit, genplanit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Departamentit të Administratës Publike i kalon në përgjegjësi administrimi oborri, kati përdhes dhe kati i parë i godinës.


3. Komisionit të Prokurimit Publik i kalon në përgjegjësi administrimi kati i dytë i godinës.

4. Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionit të Prokurimit Publik u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e godinës së përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose ta japin në përdorim të të tretëve.


5. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Departamenti i Administratës Publike, Komisioni i Prokurimit Publik dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



Kufiri i zonës që i kalon DAP dhe KPP



Kufiri i godinës që i kalon DAP dhe KPP

**VENDIM**

Nr. 705, datë 1.12.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
BRENDSHME, TË PASURIVE ME
NUMËR 8/1 DHE 8/3, ZONA
KADASTRALE 8150, ME EMËRTIMIN
“GODINA E MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE”, NDODHUR NË
BULEVARDIN “BAJRAM CURRI”,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Brendshme, të pasurive me numër 8/1 dhe 8/3, zona kadastrale 8150, me emërtimin “Godina e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, ndodhur në bulevardin “Bajram Curri”, Tiranë, sipas hartës treguese bashkëlidhur këtij vendimi, për ushtrimin e veprimtarisë administrative të këtij institucioni.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

<p>ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME</p> <p>TIRANE</p> <p>REGJISTRUES FADIL KALOSHI</p>	<p>A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 8150, NR. I PASURISE 8/1 Vël.24, Fq. 184 INDEKSI I HARTES TR-G-14, SHËNILLA 1:500 ADRESA E PASURISË: Rr. "GODINA E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE", TIRANË</p> <p>B. KUFIZIMET C. PRONARI/ET</p> <p>V _____ L _____ J _____ P _____</p> <p>D. Data: / / , Ora: _____</p>
--	---



**VENDIM**

Nr. 707, datë 1.12.2017

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE, DHE KFW
FRANKFURT AM MAIN, PËR
PROGRAMIN “REZERVA
NDËRKUFITARE E BIOSFERËS NË
PRESPË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 22, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Rezerva ndërkufitare e biosferës në Prespë”, nëpërmjet një granti prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

MARRËVESHJE FINANCIMI,
DATË 23.5.2017, NDËRMJET KFW,
FRANKFURT AM MAIN (“KFW”) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, E
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE (“PËRFITUESI”), PËR
3,500,000.00 EURO

Programi
“Rezerva Ndërkufitare e Biosferës së Prespës”

BMZ nr. 2013 66 830

Në bazë të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunimin Financiar 2013 në lidhje me “Rezervën Ndërkufitare të Biosferës së Prespës” (“Marrëveshje Qeveritare”), të nënshkruar në Tiranë, më 15.1.2016, Marrësi dhe KfW-ja nënshkruajnë Marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1**Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar**

1.1 KfW do t'i japë Përfituesit një kontribut financiar që nuk tejkalon shumën prej 3,500,000.00 euro.

Ky kontribut financiar nuk do të jetë i rimbursueshëm, me përjashtim nëse përcaktohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Përfituesi do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për programin “Rezerva Ndërkufitare e Biosferës së Prespës” (“Projekti”), për të financuar masat që synojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe të përmirësojnë kushtet e jetesës së popullsisë në Parkun Kombëtar të Prespës dhe në zonat e zgjedhura të Rezervës Biosferë dhe kryesisht të financojë kostot e këmbimit valutor. Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit (“Agjencia Ekzekutive e Projektit” ose “AEP”), do të zbatojë Projektin. Përfituesi, i përfaqësuar nga AEP dhe KfW do të përcaktojë detajet e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar me marrëveshje të veçantë.

1.3 Taksat dhe detyrime të tjera publike në ngarkim të Përfituesit dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga kontributi financiar.

Neni 2**Disbursimi**

2.1 KfW-ja do të disbursojë kontributin financiar në përputhje me progresin e Projektit dhe me kërkesë nga përfituesi i përfaqësuar nga AEP-ja. Në marrëveshjen e veçantë të përmendur në nenin 1.2 do të përcaktohet procedura e disbursimit, në veçanti dëshmitë që vërtetojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e caktuar.

2.2 KfW-ja është e detyruar të kryejë disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm nëse kushtet e mëposhtme janë përmbushur në mënyrë të pranueshme për KfW-në, në formë dhe në përmbajtje:

a) Përfituesi i përfaqësuar nga AEP-ja do të ketë demonstruar në mënyrë të pranueshme për KfW-në që të paktën tetë anëtarë personeli, me kohë të plotë, janë vendosur në mënyrë të përhershme në Parkun Kombëtar të Prespës. Kjo do të realizohet duke paraqitur CV-në dhe kontratat e punës, të shoqëruara me një urdher të Agjencisë Kombëtare për Zonat e Mbrojtura (AKZM), duke specifikuar



stacionin ekskluziv të punës së tyre në Parkun Kombëtar të Prespës.

b) Përfituesi, i përfaqësuar nga AEP-ja, do të ketë demonstruar me shkrim, në mënyrë të pranueshme për KfW-në, që Agjencia Rajonale për Zonat e Mbrojtura (ARZM) është e aftë të vendosë në mënyrë të pavarur, për aplikimin e fondeve të dedikuara Parkut Kombëtar të Prespës.

2.3 KfW do të ketë të drejtën që të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 30 dhjetor 2020.

Neni 3

Pezullimi i disbursimeve dhe rimbursimet

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet me përjashtim nëse:

a) përfituesi nuk përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së në kryerjen e pagesave në kohën e parashikuar;

b) janë shkelur detyrimet në përputhje me këtë Marrëveshje apo me marrëveshjet e veçanta përkatëse të kësaj Marrëveshjeje;

c) përfituesi nuk është i aftë të vërtetojë që të gjitha shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar, ose

d) lindin rrethana të jashtëzakonshme, të cilat pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin apo qëllimin e Projektit.

3.2 Nëse ka ndodhur ndonjë nga situatat e përcaktuara në nenin 3.1 b) apo c) dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja, e cila, sidoqoftë, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja,

a) në rastin e nenit 3.1 b), mund të kërkojë rimbursim të menjëhershëm të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e nenit 3.1 c), të kërkojë rimbursim të menjëhershëm të shumave të tilla, për të cilat Përfituesi nuk mund të vërtetojë që janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Neni 4

Kostot/Shpenzimet dhe detyrimet publike

Përfituesi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që maturohen jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, si edhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit, që lindin në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 5

Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

5.1 Ministri i Financave dhe persona të caktuar, të emëruar nga ai ose ajo, për KfW-në dhe të autorizuar nga modelet e vërtetuara nga ai ose ajo, do të përfaqësojnë Përfituesin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të skadojë derisa nga KfW-ja të jetë marrë shprehja e revokimit të saj, nga i autorizuari i Përfituesit në atë kohë.

5.2 Çdo amendim apo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje financiare do të bëhet me shkrim dhe të gjitha palët duhet të kenë rënë dakord për to. Ministri i Financave është autorizuar të nënshkruajë çdo amendim, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Amendime të kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm periudhën e disponueshme (neni 2.3) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim dhe deklaratë e dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim. Një njoftim apo deklaratë e tillë duhet të jetë marrë pasi të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme korresponduese të palës kontraktuese ose në adresën tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç njoftohet te pala tjetër kontraktuese:

Për KfW-në	Për Përfituesin
KfW	Ministria e Financave
Postfach 11 11 41	Bulevardi “Dëshmorët e
60046 Frankfurt am Main	Kombit” nr. 3.
Republika Federale e Gjermanisë	Tiranë, Shqipëri Faks: +
Faks: +49 69 7431-2944	355 4 2228494

Neni 6

Projekti

6.1 Përfituesi, i përfaqësuar nga AEP:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë Projektin në pajtim me praktikën e duhura financiare dhe inxhinierike dhe kryesisht në përputhje me konceptin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së;

b) do të caktojë, për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit, inxhinierë konsulentë të pavarur dhe të kualifikuar dhe zbatimin e Projektit të firma të kualifikuara;

c) do të lidhë kontrata për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar në bashkëpunim me konsulentin me tenderim



konkurrues ndërkombëtar paraprak;

d) do të sigurojë financimin e plotë të Projektit, duke përfshirë parashikimin e zërave të buxhetit për financimin e menaxhimit të parkut, si edhe për kosto operative të parkut dhe, me kërkesë të KfW-së, do t'i japë KfW-së dëshmi që vërtetojnë mbulimin e kostove të papaguara nga ky kontribut financiar;

e) do të mbajë apo do të marrin masa që të mbahen libra dhe regjistra, të cilët në mënyrë të qartë tregojnë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për Projektin dhe do të identifikojë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

f) do t'i mundësojë përfaqësuesve të KfW-së, në çdo kohë, të inspektojnë këta libra dhe regjistra dhe të gjitha dokumentacionet e tjera përkatëse për zbatimin dhe operimin e Projektit, si dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet në lidhje me të;

g) do t'i ofrojë KfW-së të gjitha këto informacione dhe raporte mbi Projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së; dhe

h) me dëshirën/pëlqimin e tij do të njoftojë menjëherë KfW-në për të gjitha rrethanat që pengojnë apo rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin apo qëllimin e Projektit.

6.2 Përfituesi, i përfaqësuar nga AEP dhe KfW-ja, do të përcaktojë detajet e lidhura me nenin 6.1, me një Marrëveshje të veçantë.

6.3 Për transportimin e mallrave që do të financohen nga kontributi financiar do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat njihen nga Përfituesi.

Neni 7

Publikimi dhe transferimi i informacionit në lidhje me projektin

7.1 Për të qenë në përputhje me parimet e pranuar ndërkombëtare të transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e zgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) rreth Projektit dhe se si është financuar gjatë negociatave para kontraktuale, ndërsa marrëveshja (marrëveshjet) në lidhje me Projektin është (janë) duke u zbatuar dhe në fazën paskontraktuale (më poshtë referuar si “E gjithë periudha”).

Informacioni publikohet rregullisht më faqen e

internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo nga palë të treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) rreth Projektit dhe se si është financuar ai, nuk përfshin ndonjë dokumentacion kontraktual apo informacion të detajuar sensitiv në lidhje me financat apo biznesin rreth palëve të treta të përfshira në Projekt apo financimin e tij, të tilla si:

a) informacion në lidhje me të dhëna financiare të brendshme;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatave;

d) të dhëna personale të personave fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së rreth pozicionit financiar të palëve.

7.2 KfW-ja ndan informacionin e zgjedhur rreth Projektit dhe mënyrën se si është financuar gjatë të gjithë periudhës, me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë apo subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunime dypalëshe për zhvillimin gjerman, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e statistikave dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj.

7.3 Për më tepër, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e zgjedhur rreth projektit dhe mënyrën se si është financuar gjatë të gjithë periudhës me subjektet e mëposhtme, të cilat publikojnë seksionet përkatëse të qëllimit:

a) Republika Federale e Gjermanisë, për qëllimet e Iniciativës Ndërkombëtare për Transparencën e Ndihmave

http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/weg_e/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html;

b) Tregtia dhe Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit të tregut



(<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD, për qëllim të raportimit të flukseve financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllime të vlerësimit të bashkëpunimit të përgjithshëm të zhvillimit gjerman për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>).

7.4 Gjithashtu, KfW-ja rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë për qëllime të publikimit) informacion për Projektin dhe mënyrën se si është financuar gjatë të gjithë Periudhës, te palë të treta në mënyrë që të ruajë interesat legjitime.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palë të treta nëse interesat legjitime të Përfituesit, në informacionin që nuk po transferohet, janë më të rëndësishme se interesat e KfW-së në transferimin e informacionit. Interesat legjitime të Përfituesit, në veçanti, përfshijnë konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 7.1, i cili është përjashtuar nga publikimi.

Për më tepër, KfW-ja gëzon të drejtën për të transferuar informacion te palët e treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave statutores ose rregullatore, ose për të pohuar, ose mbrojtur pretendimet, ose të drejta të tjera ligjore në procedurat gjyqësore ose administrative.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Përfituesi do të garantojë që personat e ngarkuar prej tij me përgatitjen dhe zbatimin e projektit, dhënie e çdo kontrate për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen dhe me kërkesat e disbursemeve të shumave të kontributit financiar, nuk kërkojnë, supozojnë, bëjnë, japin, premtojnë ose marrin një premtim të pagesave të paligjshme apo avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pandikuara nga ajo. Çdo boshllëk rrjedhues do të plotësohet nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.3 Përfituesi nuk mund të caktojë, transferojë, lërë peng apo hipotekojë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

8.4 Kjo Marrëveshjeje do të rregullohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i përmbushjes do të jetë Frankfurt am Main.

8.5 Marrëdhëniet ligjore të përcaktuara nga kjo Marrëveshjeje, ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit do të përfundojnë me mbarimin e kohëzgjatjes operacionale të Projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

8.6 Kjo Marrëveshjeje Financimi nuk do të hyjë në fuqi derisa Marrëveshja Qeveritare përkatëse të hyjë në fuqi, si edhe derisa të merret njoftimi i Përfituesit se të gjitha procedurat ligjore të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi, siç kërkohet nga legjislacioni shqiptar, të jenë përmbushur.

Bërë në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze
Frankfurt am Main, Tiranë
sot ___ dita e ____ 2016 sot ___ dita e
KfW _____ 2016

Republika e Shqipërisë,
i përfaqësuar nga Ministria
e Financave

VENDIM

Nr. 708, datë 1.12.2017

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR KRYEMINISTRINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, i shtohet fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime operative”.

2. Ky fond i akordohet në formën e transfertës Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe do të përdoret për financimin e organizimit të fushatës për informimin e publikut për kalimin e transmetimeve analoge në transmetime digjitale.



3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.

4. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Senida Mesi

UDHËZIM

Nr. 19, datë 20.11.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 10.2.2016, “PËR FORMATIN E AKTIT TË KONSTATIMIT, PROCESVERBALIT TË GJOBËS DHE AKTIT TË KONFISKIMIT TË AMLF-SË”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 53, pika 9, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Formatit i aktit të konstatimit, procesverbalit të gjobës dhe aktit të konfiskimit që mbahet nga inspektorët e AMLF-së, në zbatim të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohet me formatin e ri, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, për zbatimin e këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE DHE
I EKONOMISË
Arben Ahmetaj



FORMULAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT

AKT - KONSTATIMI

I mbajtur sot, më datë ____/ ____/_____, nga grupi i kontrollit të Autoritetit i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ndaj subjektit _____, me adresë qendrore _____, dhe me NUIS _____ me aktivitet, _____, me adresë sekondare _____ të qarkut (bashkia/njësia administrative) _____, dhe nr. serie të NUIS sekondar _____, ku u konstatua se:

Në mbështetje të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni _____, pika _____, germa _____, për sa u konstatuan më sipër:

Akti i konstatimit mbahet në tri kopje, nga të cilat njëra i lihet subjektit.

Për subjektin	Për AMLF
(_____)	1. _____
	2. _____
	3. _____



FORMULAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
 AUTORITETI I MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT

AKT- KONFISKIMI

I mbajtur sot, më datë ____/ ____/____, nga grupi i kontrollit të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ndaj subjektit _____, me adresë qendrore _____, dhe me NUIS _____ me aktivitet, _____, me adresë sekondare _____ të qarkut (bashkia/njësia administrative) _____, dhe nr. serie të NUIS sekondar _____, ku u konstatua se:

Në mbështetje të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni _____, pika _____, germa _____, për sa u konstatuan më sipër:

Akti i konfiskimit mbahet në tri kopje, nga të cilat njëra i lihet subjektit.

Për subjektin	Për AMLF
(_____)	1. _____
	2. _____
	3. _____

Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, e-mail: sekretaria@amlf.gov.al; web: www.amlf.gov.al



FORMULAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
 AUTORITETI I MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT

PROCESVERBAL-GJOBE

I mbajtur, sot më datë ____/ ____/____, nga grupi i kontrollit të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ndaj subjektit _____, me adresë qendrore _____, dhe me NUIS _____ me aktivitet,

_____ me adresë sekondare _____ të qarkut (bashkia/njësia administrative) _____, dhe nr. serie të NUIS sekondar _____, ku u konstatuan shkeljet e mëposhtëme:

Në mbështetje të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 53, pika ____, germa ____, organizatori _____, për shkeljet e konstatuara më sipër, dënohet me gjobë në masën _____ (_____) lekë.

Organizatori ka të drejtë të ankohet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes dijeni për procesverbalin e gjobës, në Komisionin e Apelit të Gjobave pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Gjoha të derdhet në degën e bankës _____, në numrin e llogarisë _____.

Procesverbali mbahet në tri kopje, nga të cilat njëra i lihet subjektit.

Për subjektin	Për AMLF
(_____)	1. _____
	2. _____
	3. _____

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë